

VENDIM
Nr.776, datë 24.9.2010

**PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË
KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, të shpërblehen, përkatësisht, në masën 30% dhe 20%, të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.
 2. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga mbledhja e parë e këshillit drejtues.
 3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha